



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË
ORGANIZUAR**

VENDIM

Nr. 1, datë 10 / 04 /2025

Mbi miratimin e rregullores

**“Për përcaktimin e procedurave të përzgjedhjes së Drejtorit
të Byrosë Kombëtare të Hetimit”**

Bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, nenin 148, ligjin nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, Kodin e Procedurave Administrative, nenet 4 e vijues, nenin 22, nenet 98, 99 dhe 100, urdhrin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme nr. 11794 prot., datë 07.04.2025 “*Për ngritjen e Komisionit të Përzgjedhjes të Drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit*”, me qëllim vetërregullimin institucional dhe mirëfunksionimin e brendshëm, si domosdoshmëri për të përmbushur me përgjegjshmëri funksionet dhe garantuar zbatimin efektiv të ligjit, në përputhje me parimet kushtetuese të ligjshmërisë, proporcionalitetit dhe transparencës, Komisioni i Përzgjedhjes,

VENDOSI

1. Të miratojë rregulloren “Për përcaktimin e procedurave të përzgjedhjes së Drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit”, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Kjo rregullore publikohet në faqen zyrtare të institucionit.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PËRZGJEDHJES

Arben Kraja

Altin Dumani

Behar Dibra



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR TIRANË

RR E G U L L O R E

PËR

PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË PËRZGJEDHJES SË DREJTORIT TË BYROSË KOMBËTARE TË HETIMIT

Kjo rregullore përcakton rregullat për përzgjedhjen e Drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit (më poshtë 'BKH'), si dhe procedurën e riemërimit të tij sipas detyrimeve që burojnë nga ligji nr.95/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar" (në vijim me shkurtimin "Ligji nr.95/2016").

Rregullorja zbatohet në procedurën e përzgjedhjes që kryen Komisioni i përbërë nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme dhe dy prokurorë të posaçëm me më shumë vite eksperiencë pune si prokurorë, sipas përcaktimeve në nenin 33 pika 2 e ligjit nr.95/2016 (në vijim referuar si Komisioni i Përzgjedhjes). Komisioni i Përzgjedhjes ngrihet nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, në përputhje me nenin 33 pika 2 e ligjit nr.95/2016, jo më vonë se katër muaj nga përfundimi i mandatit të Drejtorit në detyrë të BKH-së.

Procesi i përzgjedhjes dhe propozimit për emërim/riemërim do të kryhet në gjashtë (6) faza:

- a) Ekzaminimi paraprak i aplikimit;
- b) Vizitë mjekësore dhe test për aftësitë fizike;
- c) Provim i zgjeruar me shkrim (Ese) dhe test për arsyetimin logjik;
- d) Testi i poligrafit dhe intervistë në panel;
- e) Verifikim figure, deklaram i pasurisë;

Identifikimi i kandidatit fitues, trajnimi dhe propozimi për emërim/riemërim.

Çdo fazë përkufizohet nga një set standartesh minimale që duhet të arrihen përpara kalimit në fazën tjetër pasuese. Emërimi përfundimtar i kandidatit të sukseshëm bëhet nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, me rekomandim nga Komisioni i Përzgjedhjes, i përbërë prej dy prokurorësh të posaçëm dhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme (Neni 33/2).

1. Faza Fillestare e Aplikimit

Komisioni i Përzgjedhjes do të organizojë publikimin e thirrjes për aplikim për pozicionin “Drejtor i BKH-së”. Çdo aplikant për pozicionin e Drejtorit të BKH-së duhet të plotësojë një Formular Aplikimi nëpërmjet një linku në faqen e internetit të institucionit (bashkëngjitur kësaj rregulloreje). Kandidatët duhet të plotësojnë të gjitha rubrikat e Formularit të Aplikimit. Nëse një fushë apo informacion nuk është mbushur, nuk është i lexueshëm, ose është i pakuptueshëm, aplikimi do të refuzohet. Gjithashtu, nëse formulari i dorëzuar nuk tregon se aplikanti përmbush minimumin e kriterëve të përcaktuara në ligjin 95/2016, aplikimi do të refuzohet.

Kriteret e para-përzgjedhjes për Drejtorin e BKH-së janë shprehur në nenin 34/2 të Ligjit të 95/2016, sipas të cilit një kandidat:

- a) *Duhet të ketë vetëm shtetësi Shqiptare.*
- b) *Të ketë kryer nivelin e dytë të studimeve universitare për drejtësi me diplomë të barazvlefshme me “Master i Shkencave”, ose arsim i lartë policor.*
- c) *Të ketë eksperiencë pune si prokuror, punonjës i Policisë së Shtetit ose Policisë Gjyqësore, ose Hetues i Byrosë Kombëtare të Hetimit.*
- d) *Të ketë përvojë pune të paktën 5 vjet në çështje që kanë të bëjnë me veprat penale në fushën e korrupsionit, krimit të organizuar apo krimeve të rënda.*
- e) *Nëse ka qënë apo është punonjës i Policisë së Shtetit, të ketë mbajtur për jo më pak se 3 vjet gradën “Komisar”, “Kryekomisar”, “Drejtues”, apo “Drejtues i Parë”.*
- f) *Të mos jetë nën hetim apo në gjykim për një veprë penale, të mos ndodhet në kushtet e pazgjedhshmërisë në një funksion publik, sipas ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen apo ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar, si dhe të nënshkruajë Formularin e Vetëdeklarimit në zbatim të atij ligji.*
- g) *Të mos ketë mbajtur funksione politike në administratën publike ose drejtuese në parti të politike, të paktën gjatë dhjetë vitet e fundit përpara momentit të kandidimit.*

- h) *Të ketë marrë vlerësimin maksimal për aftësitë e tij profesionale, etike dhe integritetin moral, nëse i është nënshtruar vlerësimeve të mëparshme, sipas legjislacionit në fuqi.*
- i) *Të mos ketë masë disiplinore “shkarkim nga detyra”, apo të tjera në ngarkim të tij, të cilat, sipas ligjit, janë ende në fuqi në momentin e kandidimit.*
- j) *Të mos ketë qënë bashkëpunëtor, informator apo agjent i ndonjë shërbimi inteligjent.*
- k) *Gjatë periudhës 29.11.1944 - 07.02.1991) të mos ketë qënë anëtar apo kandidat i Byrosë Politike, Komitetit Qendror, anëtar i Partisë së Punës së Shqipërisë, anëtar i Kuvendit Popullor, anëtar i Presidiumit të Kuvendit Popullor, Kryetar i Gjykatës së Lartë, Prokuror i Përgjithshëm, Kryetar i Hetuesisë së Përgjithshme, anëtari i Këshillit të Ministrave, Kryetar i Degëve të Punëve të Brëndshme, punonjës i organeve të ish-Sigurimit të Shtetit, bashkëpunëtor i ish- Sigurimit të Shtetit, apo i favorizuar, anëtar i Komitetit Qëndror të Dëbim - Internimeve, hetues, prokuror, gjyqtar në procese politike, denoncues apo dëshmitar i akuzës në proceset politike të posaçme.*
- l) *Të japë pëlqimin për t’ju nënshtruar testit të poligrafit.*

Formulari i Aplikimit do të shërbejë si një mekanizëm filtrimi fillestar, i cili do t’i mundësojë Komisionit të Përzgjedhjes të identifikojë ata kandidatë që përmbushin kriteret e mëposhtme (përveç përmbushjes së kriterëve të para-përzgjedhjes në nenin 34):

- a) Mund të navigojë në sistemin elektronik të aplikimit;
- b) Mund të plotësojë të gjitha fushat në formularin e aplikimit;
- c) Mund të japë përgjigje që janë në pjesën më të madhe pa gabime drejtëshkrimore e gramatikore;
- d) Shfaq aftësi për të artikuluar një motivim të besueshëm dhe të vlefshëm për të aplikuar për pozicionin “Drejtor i BKH-së”.

Të gjithë këta faktorë do të merren në konsideratë kur të identifikohen kandidatët më të mirë në këtë fazë fillestare të filtrimit. Vetëm ata kandidatë që plotësojnë kriteret e mësipërme do të ftohen të vazhdojnë me fazën tjetër të procesit të aplikimit. Ndërkohë, ligji nuk parashikon proces apelimi për ata që nuk ftohen në fazën tjetër. Të gjithë formularët e aplikimeve do të mbahen në ruajtje sipas dispozitave të ligjit për arkivat, si pjesë e garantimit të cilësisë së përzgjedhjes së kandidatëve dhe transparencës së procesit.

Tabela : Radha e testeve të përzgjedhjes		
Kategoria e testit	Përshkrimi	Pikët maksimale
1. Testi i Aftësisë Fizike	Test kalon/ngel i forcës fizike dhe të pjesës së sipërme të trupit që përfshin palosje, sprint 300 m, pompa dhe vrapim 2.4 km.	16
2. Arsyetimi logjik	Test që mat aftësitë e kandidatit në lidhje me të menduarin kritik, kur përfshihet përpunimi i fakteve, nxjerrjes së përfundimeve dhe arsyetimit abstrakt.	30
3. Shkruajtja e eseve	Test që mat aftësitë e kandidatit për të shprehur ide me shkrim dhe saktësinë ortografike, gramatike, formatin, prezantimin dhe sa i është përmbajtur kandidati pyetjes.	30
4. Intervista e strukturuar	Test që mat aftësinë e kandidatit për të shprehur verbalisht ide, për të shprehur vlerat e tij/saj profesionale dhe për të shpjeguar zgjidhje për probleme që kanë lidhje me punën.	30
	Total	106

Procesi i përzgjedhjes ka si qëllim që t’i krijojë mundësinë Komisionit të Përzgjedhjes që të identifikojë kandidatët më të mirë. Objektiva është që të gjenden individë që janë të formuar në të gjitha aspektet, që shfaqin një kombimin pikash të forta në të katërta fushat: një person që është i aftë fizikisht dhe mendërisht, që di të shprehet mirë, mendon shpejt, e bën me krenari punën e tij dhe mund të mësojë shpejt.

Të gjithë kandidatët që kalojnë fazën e parë të përzgjedhjes do të ftohen për të marrë pjesë fillimisht në testin e aftësive fizike. Në këtë test fizik pikët do t’iu jepen kandidatëve sipas mënyrës së mëposhtme: “mjaftueshëm” (MJ) – 1 pikë; “mire” (M) – 2 pikë; dhe “shumë mire” (ShM) – 3 pikë dhe “shkëlqyeshëm” (SH) – 4 pikë.

Para se të fillojnë testin fizik kandidatët duhet të plotësojnë një pyetësor vetëdeklarues për gjëndjen e tyre shëndetësore në momentin e testimit. Një mjek i caktuar nga Komisioni i Përzgjedhjes duhet të jetë i pranishëm për të përcaktuar nëse kandidati mund të marrë pjesë në testin fizik.

2. Faza e Testit të Aftësisë Fizike (TAF)

Sipas përcaktimeve të nenit 38/2, germa “d”, e ligjit nr. 95/2016, kandidati për pozicionin e Drejtorit të BKH-së duhet të kryejë një test të aftësisë fizike (TAF), i cili mat forcën fizike dhe rezistencën. TAF duhet të realizojë matjen e forcës muskulore dhe rezistencës (palosje, pompa), fuqinë anaerobike (sprint 300 metër) dhe fuqinë aerobike (vrap 2.4 kilometër).

TAF është i përbërë nga katër (4) komponentë:

- Numri maksimal i palosjeve në një minutë;
- Sprint 300 metër i matur me kohë;
- Numër maksimal pompash në vazhdimësi (e pa matur me kohë); dhe
- Vrap 2.4 km i matur me kohë.

Tabelat më poshtë japin një sistem orientues pikësh për çdo komponent. Pikët e përgjithshme në TAF për çdo kandidat do të jenë faktor në vlerësimin përfundimtar të kandidatëve.

Testi për palosje do të kryhet në mënyrën e mëposhtme. Çdo kandidat do të jetë shtrirë me pjesën e sipërme të shpatullave që prekin dyshemenë; duart prapa koke me gishtat e gërshetuar. Gjunjtë janë të përthyer në një kënd 90 gradë me shputat e këmbëve të vendosura rrafsh mbi dysheme (këmbët mbahen në vend nga një partner i cili vendos duart në këpucët dhe gjunjtë mbi gishtat e kandidatit). Kandidati ngre pjesën e sipërme të trupit derisa fundi i qafës të jetë në një vijë me fundin e shpinës (shpina është pingul me dyshemenë); më pas kthehet në pozicionin fillestar (dmth shpatullat duhen të prekin dyshemenë). Ky është një ushtrim i matur me kohë pa ndërprerje për një minutë.

T a b e l a : S h k a l l a e p i k ë v e p e r n j ë m i n u t ë p a l o s j e																		
FEMËR %	99	95	90	85	80	75	70	65	60	55	50	45	40	35	30	25	20	15
Mosha 20 - 29	52	51	49	45	44	42	41	39	38	37	35	34	32	31	30	28	24	23
Mosha 30 - 39	43	42	40	38	35	33	32	30	29	28	27	26	25	24	22	21	20	18
Mosha 40 - 49	39	38	34	32	29	28	27	25	24	23	22	21	20	19	17	16	14	13

Mosha 50 - 59	3 1	3 0	29	25	2 4	22	22	2 1	2 0	19	1 7	1 6	1 4	12	1 2	1 1	1 0	7
		SH			SHM				M				MJ					
MASHKULL %	9 9	9 5	9 0	8 5	8 0	7 5	7 0	6 5	6 0	5 5	5 0	4 5	4 0	3 5	3 0	2 5	2 0	1 5
Mosha 20 - 29	5 6	5 5	5 2	4 9	4 7	4 6	4 5	4 4	4 2	4 1	4 0	3 9	3 8	3 7	3 5	3 5	3 3	3 2
Mosha 30 - 39	5 2	5 1	4 8	4 5	4 3	4 2	4 1	4 0	3 9	3 7	3 6	3 6	3 5	3 3	3 2	3 1	3 0	2 8
Mosha 40 - 49	4 8	4 7	4 3	4 0	3 9	3 7	3 6	3 5	3 4	3 2	3 1	3 0	2 9	2 8	2 7	2 6	2 4	2 2
Mosha 50 - 59	4 4	4 3	3 9	3 6	3 5	3 3	3 1	3 0	2 8	2 7	2 6	2 5	2 4	2 2	2 1	2 0	1 9	1 7
		SH			SHM				M				MJ					

Sprinti 300 metër do të kryhet në një pistë të përshtatshme, ovale apo të drejtë. Aplikantët do të fillojnë nga një pozicion më këmbë dhe do të vrapojnë për 300 metra. Sistemi i pikëzimit për testin e sprintit tregohet në tabelën e mëposhtme.

Tabela : Shkalla e pikëve për sprintin 300 Metra (në sekonda)																		
FEMËR %	9 9	9 5	9 0	8 5	8 0	7 5	7 0	6 5	6 0	5 5	5 0	4 5	4 0	3 5	3 0	2 5	2 0	1 5
Mosha 20 - 29	5 4	54.3	5 6	5 8	58.3	59.7	6 0	6 1	6 1	62.7	6 4	68.5	7 1	74.5	7 5	7 6	7 8	8 8
Mosha 30 - 39	5 5	56.5	6 0	63.5	6 6	66.5	6 8	69.9	7 1	7 2	7 4	75.5	7 9	80.5	8 2	85.5	93.5	100
Mosha 40 - 49	6 5	6 5	6 6	68.2	7 2	7 2	75.3	78.7	7 9	80.5	8 6	91.7	9 4	101.8	106.7	109.3	110	116
Mosha 50 - 59		7 0			8 6				9 4				113				125	
		SH			SHM				M				MJ					
MASHKULL%	9 9	9 5	9 0	8 5	8 0	7 5	7 0	6 5	6 0	5 5	5 0	4 5	4 0	3 5	3 0	2 5	2 0	1 5
Mosha 20 - 29	42.6	4 6	4 8	4 9	50.3	5 1	5 2	53.5	5 4	5 5	5 6	57.5	5 9	6 0	62.1	6 4	6 6	6 9

Mosha 30 - 39	4 2	46.1	4 9	5 0	5 1	5 2	5 3	5 4	5 5	5 6	5 7	5 8	58.9	6 1	6 3	6 5	6 8	7 0
Mosha 40 - 49	4 7	5 2	5 5	5 6	5 7	6 0	6 1	6 2	6 4	6 6	67.6	7 0	7 2	74.8	7 7	8 1	8 3	8 6
Mosha 50 - 59	5 2	5 8	6 1	6 3	66.4	6 8	7 0	7 2	7 4	77.4	8 0	82.6	83.2	8 5	8 7	8 9	9 5	9 9
		SH			SHM				M				MJ					

Testi i pompave do të kryhet në mënyrën e mëposhtme. Aplikantët fillojnë nga një pozicion i përkulur para, d.m.th., duart mbi dysHEME një deri dy pëllëmbë nga supet me bërrylat larg trupit, krahët plotësisht të hapur dhe trupi drejt, me këmbët jo më shumë se 7 cm larg njera tjetrës dhe gishtat e këmbëve që prekin dysHEMENË. Ndërkohë që krahët përkulen, trupi ulet drejt dysHEMESË derisa parakrahët janë paralel me dysHEMENË (vije e drejtë nga aksi qendror i bërrylit tek aksi qendror i shpatullës). Kandidatët përfundojnë ushtrimin pasi kthehen në pozicionin fillestar. Sistemi i pikëzimit për testin e pompave jepet në tabelën e mëposhtme.

Tabela: Shkalla e pikëve për Pompat (e pa matur në kohë)																		
FEMËR %	9 9	9 5	9 0	8 5	8 0	7 5	7 0	6 5	6 0	5 5	5 0	4 5	4 0	3 5	3 0	2 5	2 0	1 5
Mosha 20 - 29	5 3	4 2	3 7	3 3	2 8	2 7	2 4	2 3	2 1	1 9	1 8	1 7	1 5	1 4	1 3	1 1	1 0	9
Mosha 30 - 39	4 8	4 0	3 3	2 6	2 3	1 9	1 8	1 6	1 5	1 4	1 4	1 3	1 1	1 0	9	9	8	7
Mosha 40 - 49	2 3	2 0	1 8	1 7	1 5	1 5	1 4	1 3	1 3	1 1	1 1	1 0	9	8	7	7	6	5
Mosha 50 - 59	1 8	1 6	1 5	1 4	1 3	1 3	1 1	9	8	7	6	5	5	4	4	3	3	2
		SH			SHM				M				MJ					
MASHKULL %	9 9	9 5	9 0	8 5	8 0	7 5	7 0	6 5	6 0	5 5	5 0	4 5	4 0	3 5	3 0	2 5	2 0	1 5
Mosha 20 - 29	1 0 0	6 2	5 7	5 1	4 7	4 4	4 1	3 9	3 7	3 5	3 3	3 1	2 9	2 7	2 6	2 4	2 2	1 9
Mosha 30 - 39	8 6	5 2	4 6	4 1	3 9	3 6	3 4	3 1	3 0	2 9	2 7	2 5	2 4	2 1	2 0	1 9	1 7	1 5
Mosha 40 - 49	6 4	4 0	3 6	3 4	3 0	2 9	2 6	2 5	2 4	2 2	2 1	1 9	1 8	1 6	1 5	1 3	1 1	1 0
Mosha 50 - 59	5 1	3 9	3 0	2 8	2 5	2 4	2 1	2 0	1 9	1 7	1 5	1 4	1 3	1 1	1 0	9	9	7
		SH			SHM				M				MJ					

Vrapi 2.4 km do të kryhet në një pistë ovale apo në një sipërfaqe tjetër të fortë të përshtatshme, mbi tokë të sheshuar dhe të ngjeshur, pa pengesa apo bllokime e rreziqe të tjera qarkullimi. Sistemi i pikëzimit për vrapi 2.4 km tregohet në tabelën e mëposhtme.

Tabela: Shkalla e Pikëve për Vrapin 2.4 km (në minuta:sekonda)																		
FEMËR %	9 9	9 5	9 0	8 5	8 0	7 5	7 0	6 5	6 0	5 5	5 0	4 5	4 0	3 5	3 0	2 5	2 0	1 5
Mosha 20 – 29	9.23	10.20	10.59	11.34	11.56	12.07	12.51	13.01	13.25	13.58	14.15	14.33	15.05	15.32	15.56	16.43	17.11	17.53
Mosha 30 - 39	9.52	11.08	11.43	12.23	12.53	13.08	13.41	13.58	14.33	14.33	15.14	15.35	15.56	16.43	16.46	17.38	18.18	19.01
Mosha 40 - 49	10.09	11.35	12.25	13.14	13.38	13.58	14.33	15.03	15.17	15.56	16.13	16.46	17.11	17.38	18.26	18.39	19.43	20.49
Mosha 50 - 59	11.34	13.16	13.58	14.33	15.14	15.47	16.26	16.46	17.19	17.38	18.05	18.39	19.10	19.43	20.17	20.55	21.57	22.53
		SH			SHM				M				MJ					
MASHKULL %	9 9	9 5	9 0	8 5	8 0	7 5	7 0	6 5	6 0	5 5	5 0	4 5	4 0	3 5	3 0	2 5	2 0	1 5
Mosha 20 - 29	8.22	9.10	9.34	9.52	10.08	10.34	10.49	11.09	11.27	11.34	11.58	12.11	12.29	12.53	13.08	13.25	13.58	14.33
Mosha 30 - 39	8.49	9.31	9.52	10.14	10.38	10.59	11.09	11.34	11.49	11.58	12.25	12.44	12.53	13.25	13.48	14.10	14.33	15.14
Mosha 40 - 49	9.02	9.47	10.09	10.44	11.09	11.32	11.52	11.58	12.25	12.53	13.05	13.25	13.50	14.10	14.33	15.00	15.32	16.09
Mosha 50 - 59	9.31	10.27	11.09	11.45	12.08	12.37	12.53	13.25	13.53	13.58	14.33	14.35	15.14	15.53	16.16	16.46	17.30	18.22
		SH			SHM				M				MJ					

3. Faza e Esësë me Shkrim dhe Testit për Arsyetimin Logjik

Kandidatët që kualifikohen në fazën e parë të përzgjedhjes do të ftohen të marrin pjesë edhe në testin me shkrim dhe arsyetimin logjik (ese). Ata do të njoftohen me e-mail rreth datës, orës dhe vendndodhjes së testit me shkrim dhe arsyetimit logjik (ese).

Qëllimi i testit me shkrim dhe arsyetimit logjik (ese) është të identifikojë ata kandidatë që demonstrojnë nivelin më të lartë të shkrimit e leximit, kompetencë në përdorimin e MS Word, arsyetim logjik dhe aftësi për të artikuluar idetë në shkrim. Testi do të zhvillohet në ambient ku të

jenë të instaluara kompjutera. Të gjitha përgjigjet testit dhe esetë do të ruhen bazuar në ligjin mbi arkivat për të garantuar transparencën e procesit.

Përpara hyrjes në sallë dhe caktimit të një kompjuteri, çdo aplikant duhet të kryejë një proces regjistrimi duke sjellë një mjet identifikimi me fotografi (Pasaportë apo letërnjoftim). Aplikantët do të udhëzohen se nuk lejohen telefonat celularë, pajisjet elektronike, libra apo shënime në laboratorin e kompjuterëve. Në laborator nuk mund të ketë asnjë lloj komunikimi me aplikantë të tjerë pas hyrjes në laborator. Mos respektimi i këtyre udhëzimeve dhe të tjerave që do të jepen nga mbikqyrësit do të rezultojë në largimin e menjëherëshëm nga laboratori dhe mospranim të aplikimit të kandidatit për pozicionin e Drejtuesit të BKH-së.

Testi do të zgjasë 1 orë e 45 min dhe kandidati duhet t'i përgjigjet një prej tri pyetjeve për ese që kanë të bëjnë me punën e BKH-së (60 minuta) dhe 30 pyetjeve për arsyetimin logjik (45 minuta). Përgjigjet do të vlerësohen duke përdorur matricën e pikëve në **Tabelën e mëposhtme**, e cila cakton pikët për saktësinë drejtshkrimore, formatin dhe prezantimin, numrin e fjalëve dhe lidhjen me pyetjen. Maksimumi i pikëve që mund të jepen për esenë është 30 pikë, ndërsa për çdo përgjigje të saktë për 30 pyetjet me arsyetim logjik do të jepet nga një pikë. Në këtë fazë mund të arrihet një maksimum prej 60 pikësh.

Tabela 5.1: Udhëzues për Pikët						
Testi Përzgjedhës për aplikantët për pozicionin Drejtor i BKH-së						
Numri i Kandidatit:						Data e testit:
Kriteret	Pikët (10 e Lartë – 1 e Ulët)					PIKË TOTAL
Sa i është përmbajtur pyetjes	(10)	(8)	(6)	(4)	(2)	
Qartësia e argumentit	(5)	(4)	(3)	(2)	(1)	
Formati dhe prezantimi	(5)	(4)	(3)	(2)	(1)	
Numri i fjalëve	500+ (5)	400 – 500 (4)	300 – 400 (3)	200 – 300 (2)	200 ose më pak (1)	

Numri i gabimeve drejtëshkrimore (paragraf me 10 rreshta – 150 fjalë)	1 – 5 (5)	5 – 10 (4)	10 – 15 (3)	15 – 20 (2)	20+ (1)	
TOTALI PËRFUNDIMTAR						
Emri i vlerësuesit të testit:				Data e vlerësimit:		

Në përfundim të fazës së testimit fizik dhe me shkrim, Komisioni do të rendisë kandidatët e kualifikuar për të vazhduar në fazën tjetër të konkurimit, që është testi i poligrafit dhe intervista me gojë. Përzgjedhja në këtë fazë do të bëhet bazuar në disa kritere si më poshtë :

1. Rezultati i arritur në testin fizik
2. Rezultati i arritur në testin logjik me shkrim
3. Rezultati i arritur në testin “ese”
4. Eksperienca në çështje që kanë të bëjnë me vepra penale në fushën e korrupsionit, krimit të organizuar apo krimeve të rënda
5. Eksperienca si drejtues i një strukture

4. Testi i Poligrafit

Kandidatët e kualifikuar pas përfundimit të testit me shkrim dhe esesë, do t’i nënshtrohen një testi poligrafi, sipas kërkesave të ligjit nr.95/2016. Testi poligraf do të kryhet nga ekspertë ekzaminues të poligrafit të çertifikuar. Vetëm moskalimi i testit të poligrafit nuk është kriter skualifikues për kandidatin. Informacioni i raportit të ekzaminuesit të poligrafit, do të merret në konsideratë së bashku me aktet e tjera në vendimarrjen Komisionit të Përzgjedhjes.

5. Faza e Intervistës

Neni 38/2, germa “c” e ligjit nr.95/2016 kërkon që kandidatët për Drejtor të BKH-së të kalojnë një intervistë në Komisionin e Përzgjedhjes, e cila mat “aftësitë në komunikim me gojë”, dhe “zotësinë e komunikimit të ideve në mënyrë efikase”. Vetëm ata aplikantë që kanë kaluar me sukses fazën e dytë të procesit të përzgjedhjes (testin fizik dhe testin me shkrim) do të ftohen të marrin pjesë në intervistë. Intervistat përzgjedhëse, aq sa mund të jetë praktike, duhet të kryhen në

mënyrë të vazhdueshme gjatë një ose më shumë ditëve. Intervistat do të kryhen nga Komisioni i Përzgjedhjes.

Aplikantët do të informohen nëpërmjet e-mail-it, mbi datën, orën dhe vendndodhjen e intervistës përzgjedhëse. Mosparaqitja në intervistë e kandidatit pa arsye konsiderohet heqje dore nga kandidimi. Nëse justifikohet se aplikanti kishte një çështje urgjente që ia bënte të pamundur pjesëmarrjen në intervistë, Komisioni i Përzgjedhjes mund të vendosë të ftojë kandidatin për të realizuar intervistën në një datë tjetër, sa më afër të mundshme.

Qëllimi i kësaj faze të procesit të përzgjedhjes është të lejojë anëtarët e Komisionit të Përzgjedhjes të vlerësojnë kandidatin përkundrejt kritereve përzgjedhëse dhe detyrave funksionale për Drejtorin e BKH-së të specifikuar në ligjin nr.95/2016.

Intervista duhet të përfshijë sa më poshtë:

- a) Kandidati të ftohet të prezantojë veten dhe të flasë për formimin e tij.
- b) Kandidatit t'i kërkohet të përshkruajë ato cilësi udhëheqësi që ai/ajo do të sillte në BKH.
- c) Kandidati të ftohet të përshkruajë sfidat me të cilat ai/ajo do të përballej si Drejtor i BKH-së.
- d) Kandidati t'i kërkohet të përshkruajë shembuj nga eksperiencat e mëparshme të punës të cilat tregojnë aftësinë e tij/saj për të promovuar rëndësinë e balancimit gjinor në një ekip efikas.
- e) Kandidatit t'i kërkohet të përshkruajë shembuj nga eksperiencat e mëparshme që tregojnë aftësinë e tij/saj për të ndërtuar dhe ruajtur një ekip.
- f) Të përshkruajë një dilemë etike në mjedisin e punës në BKH-së dhe t'i kërkohet kandidatit si do ta trajtonte këtë dilemë.

Pyetjet duhet të kenë lidhje me pozicionin dhe nuk duhet të merren me çështje të papërshtatshme si mosha, aftësi të kufizuara, gjendja civile, përkatësitë politike/fetare, etj. Pyetjet kryesore, sa më shumë të jetë e mundur, duhet të bëhen njësoj për të gjithë aplikantët. Kjo mundëson një bazë për të krahasuar përgjigjet e aplikantëve të ndryshëm. Anëtarët e Komisionit të Përzgjedhjes mund të përsërisin apo riformulojnë një pyetje nëse është e nevojshme, ose të bëjnë pyetje plotësuese për të ndihmuar komisionin të qartësohet mbi përgjigjen e kandidatit. Anëtarët e komisionit duhet t'iu shmangen pyetjeve sugjestive (dmth ato pyetje që sugjerojnë një përgjigje të pritshme), pyetjeve me shumë pjesë (dmth ato pyetje që kanë dy ose më shumë pjesë dalluese secila prej të cilave ka nevojë për përgjigje), dhe pyetjeve të gjata dhe komplekse. Është gjithashtu

e rëndësishme të shmangen pyetjet ngatërruese dhe përdorimi i taktikave stresuese, pyetje që kërkojnë për njohuri të cilët e kanë vetëm punonjës ekzistues të SPAK, dhe pyetje rreth jetës private të aplikantit dhe përgjegjësiwe personale. Është thelbësore që të gjithë aplikantëve t’u jepet një shanc i barabartë të shpalosin aftësitë e tyre përpara Komisionit të Përzgjedhjes.

Në fund të intervistës, anëtarët e Komisionit të Përzgjedhjes pyesin nëse kandidati ka diçka për të shtuar apo nëse ka ndonjë pyetje. Kur kandidati është larguar nga salla, anëtarët e Komisionit të Përzgjedhjes diskutojnë performancën e tij/saj dhe të bien dakord mbi pikët, duke përdorur Formularin e Vlerësimit të Intervistës (Shiko tabelën më poshtë). Kandidatët mund të arrijnë një maksimum prej 30 pikësh në intervistë.

Tabela : Formulari i vlerësimit të Intervistës						
Emri i Kandidatit:			Data e Intervistës:			
Kritere	Vlerësimi (i Lartë 5 – 1 i Ulët)					PIKË TOTAL
Aftësi në komunikim (Sa efikas ishte kandidati në komunikimin e mendimeve të tij/saj?)	(5)	(4)	(3)	(2)	(1)	
Lidhja (Sa lidhje kishin përgjigjet e kandidatit me pyetjen?)	(5)	(4)	(3)	(2)	(1)	
Vetëbesimi (Sa vetëbesim shfaqti kandidati kur jepte përgjigjet?)	(5)	(4)	(3)	(2)	(1)	
Përgatitja (Deri në çfarë masë përgjigjet e kandidatit tregonin se ai/ajo ishte përgatitur për intervistën?)	(5)	(4)	(3)	(2)	(1)	
Iniciativa (Deri në çfarë mase përgjigjet e kandidatit tregojnë se ai/ajo mund të përdorë iniciativën e tij/saj për të trajtuar një problem?)	(5)	(4)	(3)	(2)	(1)	

Njohuri mbi Prokurorinë e Posaçme/BKH-në (A tregoi kandidati njohuri të mjaftueshme mbi punën që do të kryejë?)	(5)	(4)	(3)	(2)	(1)	
TOTALI PËRFUNDIMTAR						
Emrat dhe firmat e anëtarëve të komisionit:						

6. Faza e Verifikimi të Figurës, Deklarimi i Pasurisë

Pas përfundimit të intervistave, bazuar në nenit 6/3 të Ligjit nr.95/2016, kandidatët për pozicionin e Drejtorit të BKH-së do të bëjnë:

- Deklarimin e Pasurisë dhe të Konfliktit të Interesit pranë institucionit kompetent.
- Duhet të plotësojnë Formularin e Vetëdeklarimit, bazuar në ligjin nr.138/2015 (dekriminalizimi).
- Deklaratën e Kontrollit të Figurës sipas Shtojcës A të Ligjit nr.95/2016.

Verifikimet e mëtejshme të figurës do të kryhen nga *Komisioni i Posaçëm për Verifikimin e Pasurisë dhe Figurës së Kandidatëve*, sipas parashikimeve në neneve 6 dhe 57 të Ligjit nr.95/2016.

Komisioni i Posaçëm për Verifikimin e Pasurisë dhe Figurës së Kandidatëve do të dorëzojë, brenda një periudhe prej 120 ditësh, një raport të detajuar mbi ligjshmërinë e burimeve të pasurisë dhe pastërtinë të figurës të kandidatëve. Ky raport do të jetë pjesë e vlerësimit të kandidatëve nga Komisioni i Përzgjedhjes.

Në përfundim të procesit të vlerësimit të kandidatëve, Komisioni i Përzgjedhjes përcakton kandidatin më të mirë.

Bazuar në neni 32/2 të ligjit nr.95/2016, kandidati i përzgjedhur, i nënshtrohet programit të trajnimit. Pas përfundimit të programit të trajnimit Komisioni i Përzgjedhjes i dërgon emrin e kandidatit të përgjedhur për pozicionin e Drejtorit të BKH-së, për miratim Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

7. Procedura e Riemërimit në Detyrë

Procedura që ndiqet për riemërimin e Drejtorit të BKH-së është ajo e parashikuar në nenin 33, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 95/2016. Procedura e riemërimit zbatohet vetëm për Drejtuesin e BKH-së dhe jo për kandidatë të tjerë.

Drejtori i BKH-së ka të drejtë të shprehë interesin për riemërim në të njëjtin funksion, sipas parashikimeve të nenit 33, pika 2 e ligjit nr. 95/2016, duke paraqitur kërkesë pranë Prokurorisë së Posaçme jo më vonë se gjashtë muaj nga përfundimi i mandatit. Kandidati duhet të përmbushë të gjitha kushtet dhe kriteret e parashikuara në nenin 6, pikat 1-4, nenin 34, nenin 37 si dhe në nenin 38, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 95/2016.

Komisioni i Përzgjedhjes, menjëherë pas administrimit së kërkesës, e shqyrton atë dhe i kërkon kandidatit që brenda katërmëbëdhjetë ditëve kalendarike të dorëzojë dokumentacionin në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 6, pikat 1-4 dhe nenin 34 të ligjit nr. 95/2016. Pas përcjelljes së dokumentacionit nga kandidati për riemërim, Komisioni i Përzgjedhjes verifikon plotësimin e tij dhe vendos të kalojë në fazat e tjera të përzgjedhjes, të parashikuara në këtë rregullore për procedurën e emërimit.

Në rast të përmbushjes me sukses të të gjitha fazave, Komisioni njofton menjëherë kandidatin për rezultatin e vlerësimit dhe i rekomandon Këshillit të Lartë të Prokurorisë riemërimin e kandidatit. Kur nuk rezulton shprehja e interesit për riemërim, ose kur në përfundim të procedurës së përzgjedhjes rezulton se nuk janë përmbushur kriteret dhe kushtet e parashikuara në nenin 6, pikat 1-4, nenin 34, nenin 37, si dhe në nenin 38, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr.95/2016, Komisioni mbyll procedurën e riemërimit, njofton kandidatin, Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe nis procedurën e emërimit të Drejtorit të BKH-së.

8. Dispozita Përfundimtare

Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet online në faqen zyrtare të institucionit.

FORMULAR APLIKIMI PËR DREJTOR TË BKH-SË

Plotësoni të gjitha fushat. Në qoftë se formulari është i paplotë, aplikimi juaj do të skualifikohet automatikisht. Gjithashtu kini parasysh që në qoftë se një aplikim është pranuar duke u bazuar në informacion që më vonë rezulton që është i pavërtetë, procesi juaj i aplikimit ose emërimit tuaj do të ndërpritet menjëherë. Kini parasysh që kandidatit të suksesshëm mund t'i kërkohet që të udhëtojë jashtë vendit për t'u trajnuar.

PJESA 1: TË DHËNAT TUAJA PERSONALE

Emri:		Mbiemri:	
Ditëlindja:		Vendi i lindjes:	
Shtetësia:		Shtetësi tjetër:	
Numri i Pasaportës:		Numri i Pasaportës Tjetër:	
Adresa:			
Nr. i telefonit:		Adresa e emailit:	
Gjinia:		Gjatësia:	
Nr. i identifikimit personal:		Numri i Lejes së Drejtimit:	
Pesha (Kilogram):		Ngjyra e syve:	
Ngjyra e flokut:			
Atësia:		Data e lindjes së babait:	
Mbiemri i vajzërisë së nënës:		Data e lindjes së nënës:	

PJESA 2: KUALIFIKIMET E ARSIMIT TË LARTË

Emri i Kolegjit/Universitetit dhe Qytetit/Shteti	Diplomat/Kualifikimet e arritura (Vendosni Titullin ose Kualifikimin)	Nga: (m/v)	Deri: (m/v)

PJESA 3: PUNËSIMI (Fillo me punën më të fundit)				
Organizata	Vendi/Shteti	Pozicioni i punës	Nga:	Deri:

			(m/v)	(m/v)

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi:				

Emri i eprorit:	E-Mail:	Telefon:		
Organizata	Vendi/Shteti	Pozicioni i punës	Nga: (m/v)	Deri: (m/v)

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi:				

Emri i eprorit:	E-Mail:	Telefon:		

PJESA 4: AFTËSI TË TJERA				
GJUHËT E HUAJA		Gjuha juaj amtare:		
Gjuhë të tjera	E folura (C, B, A)	Shkrimi (C, B, A)	Leximi:(C, B, A)	Të kuptuarit (C,B,A)
C1, C2 = Përdorues shumë i mire ; B1, B2 = Përdorues i pavarur; A1, A2 = Përdorues bazik (Kuari i Përbashkët Evropian i Referencave për Gjuhët)				
AFTËSITË KOMPJUTERIKE				
Word Processor	Spreadshët	Prezantime	Software financiare	Kërkime në web
C = Përdorues shumë i mirë ; B = Përdorues i Pavarur; A = Përdorues Bazik				

PJESA 5: INFORMACION SHITESË DHE MOTIVIMI
Lutemi të shpjegoni arsyen pse aplikoni, duke përmbledhur profilin dhe interesin tuaj në veçanti për t'u bërë Drejtor të BKH-së. Shtoni çdo informacion që mendoni se mund të jetë me vend në aplikimin tuaj, duke përfshirë çdo aftësi, njohuri dhe eksperiencë për të cilat nuk kishte hapësirë më lart.

PJESA 6: DEKLARATË PËR MUNGESËN E KONFLIKTIT TË INTERESIT	
Deklaroj, që nuk jam palë ose përfaqësues ligjor në çështje që janë objekt hetimi nga BKH dhe Prokuroria e Posaçme si edhe nuk kam asnjë konflikt interesi, i cili do ta bënte të pamundur angazhimin tim në pozicionin e Drejtorit të BKH-së.	
PO	JO
Nënshkrimi	

PJESA 7: PYETJE PËRFUNDIMTARE			
A keni ndonjë problem shëndeti kronik, paaftësi apo gjendje të tjera mjekësore të cilat kufizojnë aktivitetin tuaj fizik?	PO/JO	(Nëse jepni detaje	po, më poshtë)
A merrni mjekime rregullisht?	PO/JO	(Nëse jepni detaje	po, më poshtë)
A është emëruar ndonjë i afërmi juaj si prokuror në Prokurorinë e Posaçme?	PO/JO	(Nëse jepni detaje	po, më poshtë)
A jeni shpallur ndonjëherë fajtor me vendim të formës së prerë për një çështje penale?	PO/JO	(Nëse jepni detaje	po, më poshtë)
A jeni në hetim ose gjykim për ndonjë vepër penale?	PO/JO	(Nëse jepni detaje	po, më poshtë)
A jeni ju tani ose a keni qenë ndonjëherë anëtar i ndonjë partie politike në Shqipëri? (Kini parasysh që një gjë e tillë nënkupton përfshirjen në aktivitetet e partisë, edhe pse ju nuk keni qenë i regjistruar si anëtar.)	PO/JO	(Nëse jepni detaje	po, më poshtë)
Keni ndonjë kundërshtim që ne të bisedojmë me punëdhënësit tuaj?	PO/JO	(Nëse jepni detaje	po, më poshtë)
Aplikantit të suksesshëm do t'i kërkohet të udhëtojë në SHBA për trajnim. A jeni në dijeni të ndonjë informacioni që do mund të ndalonte udhëtimin jashtë shteti?	PO/JO	(Nëse jepni detaje	po, më poshtë)
Nëse u përgjigjet “po” ndonjë prej pyetjeve më sipër, ju lutemi jepni detajet më poshtë.			

PJESA 8 DEKLARATA PËRFUNDIMTARE		
Duke dorëzuar këtë formular aplikimi Unë vërtetoj se deklaratat e bëra nga unë në përgjigje të pyetjeve më lart janë të vërteta, të plota dhe të sakta. E kuptoj që çdo shtrembërim ose mosdhënie e informacionit në këtë Formular Aplikimi do të rezultojë në skualifikimin e aplikimit tim dhe në ndërprerjen e çdo kontrate në të ardhmen si Drejtor i BKH-së.		
Vendi:	Data:	Emri, Mbiemri, Firma

Lista përfundimtare e dokumenteve

1.	A e keni plotësuar si duhet formularin e aplikimit?	
2.	A i keni plotësuar si duhet Deklaratat 2 dhe 3 të Vetëdeklarimit në Shtojcën B dhe Shtojcën C të Ligjit Nr. 95/2016?	
3.	Dokument që vërteton vlerësimet për aftësitë e tij /saj profesionale, etike dhe integritetin moral.	
4.	Dokument që vërteton se ndaj tij/saj nuk është marrë masa disiplinore e “shkarkimit nga detyra”, ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi sipas legjislacionit në momentin e aplikimit.	
5.	Një deklaratë për mungesën e konfliktit të interesit, që do të pohojë se kandidati nuk është palë ose përfaqësues ligjor në çështje që janë objekt hetimi nga BKH dhe Prokuroria e Posaçme si edhe nuk ka asnjë konflikt interesi, i cili do ta bënte të pamundur angazhimin e kandidatit në pozicionin e hetuesit.	
6.	A e keni marrë Raportin Mjekësor për Aftësitë Fizike nga mjeku <i>(para testimit fizik kandidati duhet të ketë me vete një Raport Mjekësor për Aftësisë Fizike të lëshuar nga mjeku)</i>?	

Shtojca B

Deklarata 2

VETËDEKLARIM

(i Kandidatëve për Pozicione të tjera në Prokurorinë e Posaçme, Kandidatët për Drejtor, Zëvendës Drejtor, Hetues, Oficer i Shërbimeve të Policisë Gjyqësore dhe Pozicione të Tjera në Byronë Kombëtare të Hetimi dhe Punonjësit e Gjykatave Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar)

Unë _____, i biri/ e bija e _____ dhe i/e _____, i/e datëlindjes _____, lindur në _____ dhe banues/ banuese në _____, me kombësi _____ dhe shtetësi _____, aktualisht i/e punësuar/emëruar pranë _____, me detyrë _____, me vullnetin tim të lirë;

Deklaroj se:

-Jam i informuar se do të caktohem me detyrë në një post që duhet të ketë besimin e posaçëm të publikut. Jam i informuar dhe jam dakord që gjatë punësimit tim të marr një telefon zyrtar fiks, një telefon celular, një numër celulari dhe një adresë poste elektronike. Jam i informuar dhe jam dakord të bëj të ditur çdo numër telefoni dhe adresa e-mail personale. Jam dakord të përdor vetëm këto mjete komunikimi elektronik. Nëse gjatë një emergjence do të më duhet të përdor njëmjet tjetër komunikimi elektronik, do t'ia raportoj këtë fakt Oficerit Përgjegjës të Byrosë Kombëtare të Hetimit. Jam i informuar dhe dakord që këta numra telefoni dhe adresa të postës elektronike t'i nënshetrohen vëzhgimit nga Oficeri Përgjegjës i Byrosë Kombëtare të Hetimit, ku përfshihet leximi i e-maileve, mesazheve tekst si dhe dëgjimi i bisedave.

- Jam i informuar dhe dakord për të deklaruar llogaritë e mia financiare si dhe për të deklaruar çdo llogari të re që mund të krijoj. Jam i informuar dhe dakord që këto llogari do të vëzhgohen nga Drejtoria e Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave.

- Jam i informuar dhe dakord që nëse nuk i respektoj këto kushte, mund të përballem me masa disiplinore ndër të cilat mund të jetë ndërprerja e mandatit tim. Jam i informuar gjithashtu se informacioni i përfutur nga vëzhgimi mund të çojë në ndjekje penale, nëse ka prova për një veprë penale.

- Jam i informuar dhe dakord se këto kushte janë të rëndësishme dhe në përpjesëtim të drejtë me nevojën për të kryer hetime, ndjekje penale dhe gjykime çështjesh të rëndësishme pa u ndikuar nga ndërhyrjet korruptive.

_____, më..... 20____

DEKLARUESI

(_____)

Shtojca B

Deklarata 3

VETË DEKLARIM

(i anëtarëve të familjes së gjyqtarëve dhe punonjësve të tjerë të Gjykatave Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar; i prokurorëve dhe punonjësve të tjerë të Prokurorisë së Posaçme; i drejtorit, zëvendës drejtorit, hetuesit, oficerit të Shërbimeve të Policisë Gjyqësore dhe pozicioneve të tjera në Byronë Kombëtare të Hetimi)

Unë, _____, anëtar i afërt i familjes së _____
(_____)¹, i/e datëlindjes _____, lindur në _____ dhe banues/
banuese në _____, me kombësi _____ dhe shtetësi _____, aktualisht i/e
punësuar/emëruar pranë _____, me detyrë _____, me vullnetin tim të lirë;

Deklaroj se:

- Jam i informuar se jam një anëtar i afërt i familjes së një personi i/e cili/cila do të caktohet me detyrë në një post që duhet të ketë besimin e posaçëm të publikut. Jam i informuar dhe jam dakord që gjatë punësimit të tij/saj telefonat e mi celularë dhe adresat e mia të postës elektronike do t'i bëhen të ditura (deklarohen) Oficerit Përgjegjës të Byrosë Kombëtare të Hetimit. Jam i informuar dhe dakord që numrat e mi të telefonit dhe adresat e mia të postës elektronike do t'i nënshtrohen vëzhgimit nga Oficeri Përgjegjës i Byrosë Kombëtare të Hetimit, ku përfshihet leximi i e-maileve, mesazheve tekst si dhe dëgjimi i bisedave.
- Jam i informuar dhe dakord për të deklaruar llogaritë e mia financiare si dhe për të deklaruar çdo llogari të re që mund të krijoj. Jam i informuar dhe dakord që këto llogari do të vëzhgohen nga Drejtoria e Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave.
- Jam i informuar dhe dakord që nëse nuk i respektoj këto kushte, anëtari i afërt i familjes mund të përballlet me masa disiplinore ndër të cilat mund të jetë ndërprerja e mandatit të tij/saj.
- Jam i informuar gjithashtu se informacioni i përfutur nga vëzhgimi mund të çojë në ndjekje penale, nëse ka prova për një vepër penale.

¹Specifiko në këtë rubrikë marrëdhënien me subjektin deklarues, për shembull i biri/e bija, vëllai/motra, nëna/babai, bashkëshorti/bashkëshortja etj.

- Jam i informuar dhe dakord se këto kushte janë të rëndësishme dhe në përpjesëtim të drejtë me nevojën për të kryer hetime, ndjekje penale dhe gjykime çështjesh të rëndësishme pa u ndikuar nga ndërhyrjet korruptive.

- Jam i informuar dhe dakord se, nëse nuk jam më një anëtar i afërt i familjes së një personi i/e cili/cila do të caktohet me detyrë në një post që duhet të ketë besimin e posaçëm të publikut ashtu siç parashikohet nga ligji, atëherë do të jetë detyrimi im të informoj menjëherë Oficerin Përgjegjës të Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave lidhur me këtë fakt si dhe të paraqes prova shkresore që vërtetojnë ndryshimin e këtij statusi.

_____, më..... 20__

DEKLARUESI

(_____)

Shtojca C

Deklarimi i llogarive financiare

(Për kandidatët për gjyqtarë dhe pozicione të tjera në gjykatat kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, kandidatët për prokurorë dhe pozicione të tjera në Prokurorinë e Posaçme, kandidatët për drejtor, zëvendës drejtor, hetues, oficer të shërbimeve të policisë gjyqësore, dhe pozicione të tjera në Byronë Kombëtare të Hetimi, si dhe anëtarët e afërt të familjes)

A. Rendisni më poshtë llogaritë tuaja financiare dhe informacionin e kërkuar:

Numri i llogarisë Financiare	Emri i mbajtësit të llogarisë	Institucioni Financiar	Shteti

B. Rendisni më poshtë llogaritë financiare të familjarëve tuaj dhe informacionin e kërkuar:

Numri i llogarisë Financiare	Emri i mbajtësit të llogarisë	Institucioni Financiar	Shteti

_____, më _____. _____

Emër, Mbiemër, Firma